

# MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE



E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe mbrohet me anë të ligjeve të shumta. Tashmë gjithçka është digjitalizuar dhe shkëmbimi intensiv i informacionit online dhe përdorimi i teknologjive të reja kërkon edhe adresimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në hapësirën virtuale.

→ **E dhënë personale** quhet çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Shembuj të të dhënave personale janë: Emri, Mbiemri; Datëlindja; Adresa; Shenjat e gishtërinjve; Numri personal; Fotografia; Profesionin dhe Kualifikimet; Të ardhurat; si dhe çdo e dhënë në lidhje me një person fizik e cila e bën të identifikueshëm drejtpërdrejtë apo tërthorazi quhet e dhënë personale.

→ **Të dhënat sensitive** janë një kategori e caktuar e të dhënave personale që përmban informacion më sensitiv për individin që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

→ Përpunimi i të dhënave personale është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

## Mbrojtja e të dhënave personale në nivel bashkie

Përpunimi i të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht, bëhet nëpërmjet mjeteve automatike, dhe me mjete të tjera që mbahen në një sistem arkivimi apo kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit pranë Bashkisë.

Çdo punonjës i strukturave të Bashkisë, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, zbaton kërkesat e ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dhe mund t'i përdorë të dhënat personale vetëm për kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

## Në këtë drejtim punonjësit e bashkisë mbajnë parasysh sa më poshtë:

- Respektimin e parimit për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;
- Kryerjen e përpunimit në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- Grumbullimin e të dhënave personale për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime;
- Të dhënat që përpunohen duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- Të dhënat duhet të jenë të sakta nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- Të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin.

## Si të mbron të dhënat personale dhe privatësinë në internet?

- Kini parasysh se interneti është një hapësirë publike dhe se të dhënat e postuara në internet janë të disponueshme për publikun.
- Privatësia në një mjedis online është po aq e rëndësishme sa është në botën reale - mos postoni në internet informacione që nuk do t'i ndanit me një person të huaj që nuk e njihni.
  - Bëni kujdes në shpërndarjen e të dhënave sensitive në internet. Shkëmbimi i të dhënave personale është më e sigurt në internet, por ndarja e informacioneve private nuk është e sigurt.
  - Lexoni me kujdes Kushtet e Shërbimit dhe Politikën e Privatësisë përpara se të filloni të përdorni ndonjë platformë, aplikacion ose shërbim të internetit.

- Kur regjistrohesh në një portal apo kur krijoni adresë në faqe të ndryshme interneti, krijoni një kod (password) të vështirë dhe mbajeni mend atë.
- Mendoni në mënyrë kritike! Përpara se të postoni ndonjë informacion ose të dhëna personale në internet, mendoni për imazhin e vetes që u dërgoni të tjerëve dhe mënyrën se si e formoni identitetin tuaj digjital.

